

Takimi i XIV i Nënkomitetit për Ekonominë, Çështjet Financiare dhe Statistikat (ECOFIN) mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian

Në datën 29 shtator, 2022 u zhvillua në Tiranë takimi i XIV i Nënkomitetit BE-Shqipëri për çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat – ECOFIN.

Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucion raportues, mori pjesë në këtë takim me znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm dhe znj. Dëshira Huqi, Përgjegjëse Sektori.



Sekretarja e Përgjithshme e KLSH-së, i njohu përfaqësuesit e BE-së me zhvillimet dhe përditësimin e aktiviteteve institucionale, në vijim edhe të raportimit periodik të përcjellë nga KLSH në muajin korrik, si dhe iu përgjigj pyetjeve të ngritura nga ekspertët mbi: statusin aktual të amendimeve ligjore; statusin e ndjekjes së rekomandimeve nga institucioni në bazë të planit të auditimeve; si dhe marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë në kuadër të sesioneve dëgjimore të organizuara lidhur me raportet e KLSH-së, si një mjet kontrollues, me qëllim rritjen e mbikqyrjes ndaj qeverisë.